1	Kontrollime K3	31	22	9
2	Riparim në punëtori	16	1	15
3	Riparim në teren	1	0	1
4	Gdhendje te rrotave	9	0	9

4.1.2 Mirëmbajtjen e Vagonëve për Transportin e Mallrave – Matja e Produktivitetit

Në vagonët e mallrave janë shpenzua 701 orë dhe atë
-Për Kontrollim K3 – 496 orë apo 71% e orëve të shpenzuara për mirëmbajtjen e vagonëve te mallrave
- Për riparim në punëtori 142 orë apo 20% e orëve të shpenzuara për mirëmbajtjen e vagonëve te mallrave
- Për riparim në teren 5 orë apo 1% e orëve të shpenzuara për mirëmbajtjen e vagonëve te mallrave
- Për gdhendje të rrotave 68 orë apo 8% e orëve të shpenzuara për mirëmbajtjen e vagonëve te mallrave.

4.1.3 Mirëmbajtjen e Vagonëve për Transportin e Udhëtarëve dhe Mallrave – Matja e Efikasitetit

- Në vagonët e mallrave janë kryer:

31- Kontrollime tremujore K3, koha mesatare për 1 kontrollim tre mujor K3 është 16 orë, gjashtë mujorin e 2018 ka qenë 10.86 orë.
16 - Riparime ne punëtori, koha mesatare për 1 riparim në punëtori është 8.88 orë, gjashtë mujorin e 2018 ka qenë 4.0 orë.
1 - Riparime ne teren, koha mesatare për 1 riparim në punëtori është 5.0 orë, gjashtë mujorin e 2018 ka qenë 4.0 orë.
9 – Gdhendje të rrotave, koha mesatare për 1 riparim në punëtori është 6.44 orë, gjashtë mujorin e 2018 ka qenë 4.0 orë.

4.1.4 Kontrollimi K3 i vagonëve të NewCo Ferronikeli.

Në vagonët e NewCo Ferronikeli është kryer kontrollimi K3 sipas kontratës si dhe janë kryer riparimet tjera që nuk janë në kontratë e që ka qenë e nevojshme të kryhet.
Në vazhdim është dhënë vlera e punëve të kryera dhe materialit të shpenzuar për periodën janar qershor 2019 dhe është krahasuar me të njëjtën periodë të vitit të kaluar.
Janar- Qershor 2019 është, 14818 **€**,
Janar- Qershor 2018 është, 3519 **€**

4. Shpenzimet e vajrave.

Në vazhdim janë dhënë shpenzimet e vajrave për mirëmbajtjen e mjeteve tërheqëse për periudhën kohore janar- qershor 2019

Muajt	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Σ
Vaj Llokomoll HS 40	600	360	600	520	420	1110	3610
Antifriz	175	25	50				250
Vaj ATF	18	18	5		1		42
Vaj SAE 15/40	64		6	50			120

Vaj SAE 30	60	11	100	16	28	10	225
Vaj EP 90	3				30		33
lubrifikant Viskolit 20			180				180
Vaj kompresori			35		12		47
Vaj Hidroll 68		20	25		32	20	97
Uje per xhama	13	3			12		28

5. Buxheti

Në vazhdim është dhënë tabela ku prezentohen kerkesat për buxhetim të mjeteve si dhe buxheti i pa shfrytezuar.

	Vijat buxhetore	**Kodi**	**Njësit buxhetore**	**Buxhet vjetor**	**Kërkesat për buxhetim**	**Mbetja**
Vajrat dhe lubrifikantet						
	Vaji për mjete lëvizëse	60103	Lok/tm	30000	25193.10	4806.9
			Vagonët			
	Gjithsejtë			**30000**	**25193.10**	**4806.9**
Pjesët rezervë dhe materialet						
1	Blerje materiale të tjera	60121	Lok/tm	0	**0**	0
			Vagonët	2200	560	1640
2	Pjesë ndërrimi	60122	Lok/tm	28300	28300	0
			Vagonët	10000	7200	2800
3	Material për njesit e transportit	60123	Lok/tm	2900	665	2235
			Vagonët	1600	803	793
4	Mirëmbajtje dhe riparime për makina	60124	Lok/tm	800	465	335
			Vagonët			
Gjithsejtë				**45800**	**37993**	**7803**

IV.5. Sfidat

Sfidat me të cilat jemi ballafaqua në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019 janë:

- Mungesa e ujit të zbutur për furnizimin e lokomotivave dhe trenave motorik.
- Mungesa e ngrohjes së objekteve gjatë sezones se dimrit për shkak të dëmtimit të rrjetit të ngrohjes
- Depërtimi i ujit nga të reshurat atmosferike për shkak të dëmtimit të kulmit në punëtorin e lokomotivave dhe trenave motorik.
- Ndotja e punëtorive nga shpezët të cilat hynë në punëtorin e trenave motorik dhe lokomotivave.
- Thyerja e xhamave në punëtorin e tornos ku rrezikohet edhe dëmtimi i tornos.
- Vjedhja në punëtori e baterive të vjetra dhe tentimi për të vjedh vegla të punës, presën hidraulike në punëtorin e trenave motorik.

V. PROJEKTET KAPITALE

Nr	Titulli i Aktivitetit të Prokurimit	Kontraktuar	Buxheti i zotuar	Vlera e kontratës	Koment
1	Furnizimi me sistem te centralizuar per menaxhimnin e kontabilitetit dhe financave		20.000,00		Ne procedurë
2	Renovimi i objektit ndihmës te tërheqjes se trenave		67.751,19		Ne procedurë
3	Furnizimi dhe Instalimi i pajisjeve te teknologjisë informative		43.000,00		Ne procedurë
4	Furnizimi me mjete lëvizëse hekurudhore - Furnizimi me tren motorik për nevojat e transportit te udhëtarëve		1.100.000,00		Anuluar
5	Furnizimi dhe Instalimi i pompës për dhënien e naftës		6.000,00		Anuluar
6	Renovimi I objektit te servisit te trenave motorrik		9.720,00		Anuluar
7	Furnizimi me filtra për lokomotiva		5.765,00		Ne procedurë
8	Shërbimet e sigurimit fizik te objekteve te Trainkos Sha		55.000,00		Ne procedurë
9	Furnizim me papuçe frenuese për vagonë		7.200,00		Ne procedurë
10	Furnizimi me vetura për nevojat e Trainkos SHa		20.000,00		Ne procedurë
11	Zbrazja e rezervarit nga ujërave e zeza në vagonët e transporti të udhëtarëve	**Korrik**	2.700,00	2,300.00	Kontraktuar
12	Furnizim me pjesë për gjenerator të ngrohjes së lokomotivës		5.000,00		Anuluar
13	Furnizimi me material administrativ	**Maj**	6.000,00	5,181.08	Kontraktuar
14	Furnizimi me Toner	**Maj**	5.000,00	3,069.18	Kontraktuar
15	Furnizimi me poqa elektrik për lokomotiva		3.635,00		Anuluar
16	Shërbimet mirëmbajtjes së arkave fiskale - DP - 05 për nevojat e Trainkos sh.a		6.500,00		Anuluar
17	Furnizimi me material higjenik	**Qershor**	5.000,00	4,993.28	Kontraktuar
18	Furnizimi me kontejner të plumbit për izolim radioaktiv	**Qershor**	2.000,00	1,875.02	Kontraktuar
19	Furnizimi me poqa elektrik për lokomotiva		3.635,00		Anuluar
20	Furnizimi me pjesë për lokomotivën 2710 009	**Maj**	2.550,00	2444.44	Kontraktuar
21	Furnizim me modul për Lokomotivën 009	**Maj**	2.500,00	2,340.00	Kontraktuar
22	Furnizimi me ujë të pijshëm	**Maj**	4.000,00	2,891.00	Kontraktuar
23	Shërbimet e sigurimit të automjeteve	**Korrik**	1.600,00	1,599.14	Kontraktuar
24	Furnizimi i kompresorit për trenin motorik 5800 001	**Korrik**	2.200,00	1,444.00	Kontraktuar

VI. KONTESTET

HYRJE

Zyra Ligjore e Hekurudhave të Kosovës -Trainkos- Sh.A. gjatë periudhës kohore Janar – Qershor ka mbajtur gjithsejtë 22 (njëzet e dy) seanca gjyqësore, kurse në procedurë ka pasur 8 (tetë) konteste nga marrëdhënia e punës, 4 (katër) konteste për kompensim dëmi, 1 (një) kontest për pasurim pa bazë dhe 9 (nëntë) lëndë në procedurë të përmbarimit.

KONTESTET PËR KOMPENSIM DËMI

Nga kontestet e kompensimit të dëmeve gjatë periudhës janar – qershor 2019, HK-Trainkos-SH.A. ka pasur në procedurë 4 (katër) konteste:

Nr.	**Nr. i lëndës**	**Vlera euro (€)**	**Cilësia e HK – Trainkos SH. A. si palë në procedurë**
1.	C.nr.79/14	4,999.00	E paditur Bekë Mulaj
2.	C.nr.1111/13	4.500.00	E paditur Genc Berisha
3.	C.nr.724/17	50.000.00	E paditur Afërdita Qallapeku
4.	C.nr.3271/17	220.00 rentë mujore	E paditur Hanemshahe Gaxhiqi

Prej kontesteve të kompensimit të dëmeve 2 konteste kanë përfunduar në shkallë të parë në favor të HK-Trainkos-SH.A. paditës Genc Berisha dhe Hanemshahe Gaxhiqi.

3 konteste në shkallë të dytë në favor të paditësve Nazife Demolli, Hajdin Osmani, Mehush Zogjani etj.

Në mënyrë tabelorë do të paraqesim aktgjykimet e arritura gjatë kësaj periudhe, gjithsejtë 5 aktgjykime:

Nr.	Nr. lëndës	Vlera euro (€)	Cilësia e HK – Trainkos SH.A si palë në procedurë	Veprimet e ndërmarra në procedurë
1.	Rev.nr.398/2018	44,032.60	E paditur	Është arritur marrëveshje paditëse Nazife Demolli
2.	Rev.nr.385/2018	76,573.50	E paditur	Është arritur marrëveshje paditës Hajdin Osmani
3.	C.nr.1111/13	4,500.00	E paditur	Aktgjykimi C.nr.1111/13 i shkallës së parë në favor të Trainkos SH.A. paditës Genc Berisha
4.	C.nr.3271/17	220.00 rentë mujore	E paditur	Aktgjykimi C.nr.3271/17 i shkallës së parë në favor të Trainkos SH.A. Hanumshahe Gaxhiqi
5	Ac.nr.4635/14	9,500.00	E paditur	Aktgjykimi Ac.nr.4635/14 i shkallës së dytë në favor të paditësve, Mehush Zogjani etj.

KONTESTET PËR PAGIM BORXHI

Nga kontestet e borxhit gjatë periudhës janar - qershor 2019, HK - Trainkos - SH.A. kemi pasur 1 (një) kontest në procedurë:

Nr.	Nr. lëndës	Vlera në euro (€)	Cilësia e HK – Trainkos SH.A si palë në procedurë	Veprimet e ndërmarra në procedurë
1.	IV.EK.nr.679/18	47,311.49	Paditëse	Rail Pro Sh.p.k. lënda në shkallë të parë

Nga kontestet e borxhit gjatë kësaj periudhe nga Gjykata e Apelit në Prishtinë kemi pranuar një aktgjykim të formës së prerë në favor të Trainkos SH.A. E paditur Beta Sh.p.k. vlera e kontestit 4,211.60 €.

AKTGJYKIMET

Nr.	Nr. lëndës	Vlera në euro (€)	Cilësia e HK – Trainkos SH.A si palë në procedurë	Veprimet e ndërmarra në procedurë
1.	IC.nr.212/15	4,211.60	Paditëse	Aktgjykim i plotfuqishëm në favor të Trainkos SH.A. Beta Sh.p.k

KONTESTET E PUNËS

Zyra Ligjore e HK-Trainkos-SH.A. gjatë periudhës janar - qershor 2019, në procedurë në shkallë të parë ka pasur gjithsejt tetë (8) konteste pune si vijon:

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera euro (€)	Cilësia e HK – Trainkos SH.A. si palë në procedurë
1.	C.nr.806/18	1,260.00	E paditur nga Ali Krasniqi
2.	C.nr.1430/18	1,410.00	E paditur Ibrahim Tërnava
3.	C.nr.254/18	2,397.66	E paditur Shefki Krasniqi
4.	C.nr.1512/18		E paditur Sabri Kelmendi
5.	C.nr.771/18	1,380.00	E paditur Avdi Pllana
6.	C.nr.1537/18	1,581.00	E paditur Ali Mjeku

7.	C.nr.2043/16		E paditur Zair Imeri
8.	C.nr.1969/16		E paditur Nexhmije Dragusha

Prej kontesteve nga marrëdhënia e punës

5 konteste pune për pagesën e shpërblimeve jubilare
1 kontest për kthim në pozitën e mëparshme të punës
2 konteste për kthim në punë

Gjatë kësaj periudhe kohore Zyra Ligjore ka pranuar këto aktgjykime dhe aktvendime të cilat do ti paraqesim në tabelat si vijon:

AKTGJYKIMET

Nr.	**Nr. lëndës**	**Vlera euro (€)**	**Cilësia e HK – Trainkos SH.A si palë në procedurë**	**Veprimet e ndërmarra në procedurë**
1.	C.nr.806/18	1,260.00	E paditur	Aktgjykimi C.nr.805/18 i datës 17.01.2019 pjesërisht në favor të paditësit Ali Krasniqi. Është ushtruar ankesë. Vlera e kontestit 420.00 €. Lënda gjendet në shkallë të dytë, kontesti ka të bëjë me paga jubilare
2.	Ac.nr.725/14		E paditur	Aktgjykimi i plotfuqishëm në favor të Trainkos SH.A. paditës Gasper Laci, është ushtruar Revizion nga paditësi. Gjykata Supreme e Kosovës ka vendosur në favor të Trainkos SH.A. Rev.nr.137/2019 kontest i zgjidhur

3.	C.nr.771/18	1,380.00	E paditur	Aktgjykimi C.nr.771/18 i dt.26.02.2019 në favor të paditësit Avdi Pllana, është ushtruar ankese, lënda gjendet në shkallë të dytë (paga jubilare)
4.	C.nr.774/18	1,410.00	E paditur	Aktgjykimi C.nr.774/18 i dt.26.02.2019 në favor të paditësit Ibrahim Tërnava – është ushtruar ankesë, lënda në shkallë të dytë, kontesti ka të bëjë me paga jubilare
5.	C.nr.2043/16	Kthim në punë	E paditur	Aktgjykimi C.nr.2043/16 i dt.16.05.2019 në favor të Trainkos SH.A. paditës Zair Imeri
6.	C.nr.1537/18	1,440.00	E paditur	Aktgjykimi C.nr.1537/18 i dt.05.03.2019 pjesërisht në favor të paditësit Ali Mjeku, është ushtruar ankesë. Lënda gjendet në shkallë të dytë (paga jubilare)
7.	C.nr.254/2018	2,397.66	E paditur	Aktgjykimi C.nr.254/18 i dt.16.01.2019 në favor të paditësit Shefki Krasniqi, është ushtruar ankesë. Lënda gjendet në shkallë të dytë (paga jubilare)

AKTVENDIMET

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera euro (€)	Cilësia e HK – Trainkos SH.A si palë në procedurë	Veprimet e ndërmarra në procedurë
1.	C.nr.1537/18	1,581.00	E paditur	Ali Mjeku –Përgjigje në padi
2.	C.nr.771/18	1,380.00	E paditur	Avdi Pllana –Përgjigje në padi
3.	C.nr.702/18		E paditur	Sabit Berisha –Përgjigje në padi
4.	C.nr.774/18	1,410.00	E paditur	Ibrahim Tërnava –Përgjigje në padi

LËNDËT PËRMBARIMORE

Gjatë kësaj periudhe Zyra Ligjore në procedurë ka pasur 9 lëndë përmbarimore:

Nr.	Nr. i lëndës	Vlera e shpenzimeve në euro (€)	Cilësia e HK – Trainkos SH.A si palë në procedurë	Veprimet e ndërmarra në procedurë
1.	PPP.nr.205/18	82,973.90+ 4,520.62	Debitor	Aktvendimi PPP.nr.205/18 në favor të kreditorit Rail Pro Sh.p.k.
2.	P.nr.126/19	79,037.52	Debitor	Flamuri N.T.P.
3.	P.nr.30/19	11,022.86	Kreditor	Në procedurë të përmbarimit Bajraktari SH.P.K në favor të Trainkos SH.A.
4.	PPP.nr.17/18	4,894.00	Debitor	Abedin Bajrami e përfunduar në favor të kreditorit
5.	PPP.nr.535/2016	2,000.00	Debitor	Euroshped

6.	PPP.nr.1110/19	1,888.00	Debitor	Infinit Sh.p.k.
7.	Ac.nr.148/17	376.00	Debitor	Gratis Commerce
8.	C.nr.212/15	4,211.60	Kreditor	Beta Sh.p.k.
9.	P.nr.299/2017	4,657.84	Debitor	Sekuriti Sh.p.k.

Po ashtu Zyra Ligjore gjatë kësaj periudhe ka kryer edhe punë të tjera sa i përket përgatitjes së parashtresave, ankesave, revizioneve, prapësimeve etj.

VII. TRANSAKSIONET E REALIZUARA JANAR- QERSHOR 2019

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse dhe ato në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës:

Transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2019	231.13
Inkasimet e pranuara gjatë muajve janar – qershor 2019	784,007.76
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – qershor 2019	783,958.91
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 30.06.2019	279.98

Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2019	54,554.75
Inkasimet e pranuara gjatë muajve janar – qershor 2019	54,538.75
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – qershor 2019	109,093.35
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 30.06.2019	0.15

BILANCI I GJENDJES		
NP TRAINKOS SH.A	**GJENDJA FILLESTARE 01/01/19**	**GJENDJA PERFU. 31/06/19**
Mjetet themelore - vlera neto sipas librave	**5,499,876.89**	**5,015,766.62**
Mjetet Qarkulluese	**2,820,464.19**	**2,705,317.62**
Stoqet	429,002.01	411,863.73
Paraja	54,938.35	88,597.24

Llogarite e arketueshme	1,871,622.66	1,764,117.29
Kërkesa tjera të arketushme	440,107.68	415,945.87
Parapagimet	24,793.49	24,793.49
Total Mjetet Qarkulluese dhe themelore	**8,320,341.09**	**7,721,084.24**
Detyrimet afatshkurta	**1,898,848.82**	**1,980,176.66**
Llogarite e pagueshme	1,549,822.50	1,625,679.62
Te pagueshme tjera - detyrime	3,140.61	3,123.92
Detyrime tatimore	345,885.71	431,144.99
Llogarite tjera		-79,771.87
Detyrimet afatgjata	**3,186,968.59**	**2,724,587.26**
Kapitali	**5,305,403.20**	**5,307,691.64**
Fitimi/Humbja e bartur	-2,070,879.52	-2,070,879.52
Fitim/ Humbja e vitit		-220,491.80
Total detyrimet dhe kapitali	**8,320,341.09**	**7,721,084.24**

VIII. AKTIVITETET NË DEPARTAMENTIN E ZHVILLIMIT TË BIZNESIT

VIII. 1 Planifikimi dhe Zhvillimi i Biznesit

Nëse e kemi parasysh se planifikimet për sektorin hekurudhorë duhet dhe janë afatgjata, atëherë edhe synimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës janë që me shfrytëzimin e mundësive që ofrojnë IFN-të dhe Bashkësia Evropiane (BE) me mekanizmat e sajë fillimisht të bëhet investimi në Linjat ekzistuese hekurudhore. Pastaj të vazhdohet me Linjat tjera të reja të identifikuara me "Strategjinë Sektoriale dhe Transportin Multimodal 2015 – 2025 dhe Plani i veprimit 5 vjeçar". Viti 2019 është viti i fillimit të projektit "Rehabilitimi i Linjës së 10-të hekurudhore" Hani i Elezit – Leshak. Me këtë fillon procesi i plotësimit të parakushteve të përcaktuara me "Librin e bardhë" të publikuar për zbatim nga BE-ja në mars 2011. Me këtë synohet krijimi i një zone të mirëfilltë të transportit të përbashkët Evropian duke i eliminuar të gjitha pengesat e mbetura nacionale dhe për të lehtësuar integrimin dhe operimin funksional të transportit hekurudhorë multimodal dhe intermodal.

Procedimi i realizimit të projektit sipas planifikimeve në Rehabilitimin e Linjës Lindje – Perëndim do të krijon parakushte për shtrirjen e rrjetit hekurudhorë në pjesën kah kalon ky rrjetë dhe plotësojë parakushtet për Linjat e reja që janë paraparë me planifikimet strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Rëndësi të veçantë ka vazhdimi i Linjës hekurudhore nga Prizreni për Shqipëri, realizimi i kësaj lidhje do të mundëson edhe qasjen në Portet e Shqipërisë. Kjo do mundësojë që të avancojë qarkullimin e mallrave me tren jo vetëm për Republikën e Kosovës por edhe shtetet tjera në kontinent nga Portet gjeografikisht strategjike të Shqipërisë.

Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese kem zhvilluar aktivitete të ngjeshura në prezantimin e nevojës për një Plan Biznesi afatmesëm (3 apo 5 vjeçar) tek IFN-të dhe mistria/ministritë përkatëse brenda Qeverisë së Kosovës. Kontaktet e vazhdueshme me BERZh-in dhe BEI-në kanë rezultuar me konkretizim të kërkesës sonë për mbështetjen financiare të një Asistence Teknike që TRAINKOS-it do të i mundësonte përgatitjen e Plani të Biznesit paralel me zhvillimet tjera në sektor.

Kontaktet e rregullta me partnerët regjional kanë vazhduar, kjo kryesisht me ata të Republikës së Maqedonisë meqenëse është kanali i vetëm ndërkombëtar në të cilin kemi qasje, dhe kanë qenë të përqendruara në krijimin e mundësive për të rritur transportin, me relaksimin e situatës së krizës ekonomik edhe proceseve rehabilituese politike në dhe me Republikën e Greqisë.

Transporti i xehes, lëndës finale dhe thëngjillit për New Co Ferronikeli nga eksporti, importi dhe transporti minierë – punëtori në Drenas po vazhdon sipas planifikimeve të parapara me kontratë me disa vonesa të shkaktuar nga faktorët e jashtëm.

Periudhën raportuese e karakterizon angazhimin tonë në forma indirekte me kompanitë që janë përzgjedhur dhe janë bartëse të realizimit të projektit "Rehabilitimi i Linjës së 10-të hekurudhore". Konkretisht seksioni Fushë Kosovë – Hani i Elezit do të jetë pjesa e parë për zbatim të projekteve të rehabilitimit / modernizimit të linjave ekzistuese të hekurudhave në territorin e Kosovës. Kontaktet tona kanë qenë paralele me dy kompanitë e poshtëpërmendura:

GCF (Generale Construzione Ferroviarie S.p.A.), kompani fituese për zbatimin e projektit – Rehabilitimi i seksionit Fushë Kosovë – Hani i Elezit) dhe
Konzorciumit mes "Walter Beton GmbH" nga Gjermania me "Armos Precast S.A." nga Greqia dhe "CRON" nga Kosova - nën kontraktorë për prodhimin dhe furnizimin me traversa.

Me kompaninë GCF është biseduar për mundësi të ndryshme bashkëpunimi. Nga të gjitha kërkesat për bashkëpunim, mundësitë në të cilat është vepruar gjatë periudhës raportuese janë:

1. Dhënia me qira e vagonëve në dispozicion të TRAINKOS-it dhe
2. Shqyrtimi i të gjitha mundësive për të përfituar nga mundësia e mirëmbajtjes dhe riparimit të mjeteve lëvizëse.

VIII. 1. 1. Koordinimi i proceseve me ARH-në dhe Institucionet tjera.

Periudha raportuese gjithashtu rezulton me angazhimin e vazhdueshëm në plotësimin e obligimeve në raport me Ministrinë e Infrastrukturës (MI), ARH-në, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZhE) dhe BERZh.

- ARH, konkretisht Departamenti i Rregullimit të Tregut duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë që ka, ka kërkuar dhe është informuar në periudha të rregullta për proceset e diskutimit të Marrëveshjes së OShP-së 2018 – 2022 me Ministrinë e Infrastrukturës;
- Departamenti i Rregullimit të Tregut duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë që ka, është furnizuar me statistika zyrtare për transportin e mallrave dhe udhëtarëve në periudha të rregullta mujore;
- Enti Statistikor i Kosovës është furnizuar me statistika zyrtare për transportin e mallrave dhe udhëtarëve në periudha të rregullta raportuese;
- Gjatë periudhës raportuese është bërë koordinimin dhe zhvillimin e aktiviteteve në realizimin e projektit të aprovuar nga Kryeministria – Muzeu i Bllacës. TRAINKOS-i ka mbështetë projektin me dhënjen dhe riaftësimin e tre vagonëve të udhëtarëve dhe një lokomotive;
- Përmes SEETO-s për procesin e monitorimit të Raportit të Progresit janë plotësuar kërkesat sipas pyetësorëve të kërkuar dhe në këtë periudhë kemi rishikuar avancimet në procesin e "masave të buta" për vitin 2019 që janë bazë për zbatim dhe kërkesa për zhvillim dhe avancim;
- Me koordinimin e ARH-së dhe me pjesëmarrjen aktive të TRAINKOS-it dhe INFRAKOS-it është krijuar grupi punues për identifikimin e legjislacionit dytësorë (bazik dhe teknik) që është në zbatim. Kjo sipas kërkesës së SEETO-s për të parapërgatitur një projekt (asistencë teknike) për shtetet e Evropës Jug – Lindore në krijimin e legjislacionit të përbashkët të ngjashëm me të EU-së dhe
- Në bazë të kërkesës dhe veprimeve të ndërmarra është plotësuar dokumentacioni i nevojshëm dhe aplikimi për licencimin e katër makinistëve të rinj të kompanisë.

VIII. 1.2 Aktivitet e Marketingut

TRAINKOS SH.A. edhe gjatë kësaj periudhe raportuese ka vazhduar me përmbushjen e obligimeve të dala nga Plani i Biznesit dhe Plani i Punës i Departamentit të Biznesit për monitorimin dhe vizitat e rregullta drejt klientëve të rregullt duke qenë afër tyre për shqyrtimin e çdo ankese apo kërkese që kanë në drejtim të kompanisë.

Po ashtu gjatë këtij gjashtëmujori janë zhvilluar kontakte dhe takime me klient potencial, me të cilët janë shqyrtuar mundësit e realizimit të transportit me hekurudhë.

Po ashtu nuk kanë munguar edhe aktivitet në rrjetet sociale, duke prezantuar shërbimet tona në transportin e mallrave dhe në transportin e udhëtarëve.

VIII. 1. 3. Raportimi i rregullt vjetor në Asociacionet tjera Hekurudhore

Raportimet e rregullta vjetore në CIT (International Rail Transport Committee) vazhdojnë të bëhen. Fillimi i vitit 2019 rezulton me vazhdimin e ngecjeve në aktivitetet për gjetjen e modalitete për të u anëtarësuar në asociacionet hekurudhore ndërkombëtare. Vlenë të përmendet se kjo ende po varet nga politikat shtetërore të cilat po zhvillohen dhe gatishmëria e institucioneve relevante qeveritare për të vepruar në këtë drejtim.

Projekti për mbështetjen e shteteve të Evropës Jug – Lindore i filluar në vitin 2018 e që do të krijoj mundësinë e planifikimeve afatmesme në planet afatmesme deri në vitin 2020 të këtyre shteteve sipas kërkesave që rrjedhin nga BE është në zbatim e sipër. Ky projekt i rëndësishëm planifikohet të zgjatë një vit e gjysmë nëse e kemi parasysh kohën e nevojshme që planifikimet të inkorporohen në planet afatmesme dhe afatgjata për secilin shtet veç e veç. Zbatimi i projektit për TRAINKOS-in do të ishte mbështetje e duhur që së bashku me strategjitë tjera relevante për sektor të përgatitë Strategjinë afatmesme.

IX. SFIDAT KRYESORE GJATË PERIUDHËS JANAR – QERSHOR 2019 DHE VEPRIMET PËR TË ARDHMEN

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2019 si edhe viteve tjera kompania ka vazhduar të ballafaqohet me shumë sfida si në vijim:

1. Mos respektimi i Ligjit të Hekurudhave të Kosovës Nr. 04 / L-076 për mbulimin e shpenzimeve për OSHP, nënshkrimi i Marrëveshjes për OShP 2018 – 2022 më 18.04.2018 kufizon linjat në minimum dhe sipas planifikimeve në KASh 2018 – 2021 nuk parashihet ndonjë zhvillim / reformë në këtë lloj të transportit publik ;
2. Mungesa e ligjit për sigurinë në komunikacionin hekurudhor;
3. Proceset e shumta gjyqësore të trashëguara nga ish-Hekurudhat e Kosovës;
4. Mos funksionimi i të gjitha linjave hekurudhore;
5. Vonesat në realizimin e projektit "Modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore" si infrastrukturë bazë që bën lidhjen me pjesën tjetër të Evropës (infrastrukturë dhe reforma të sektorit hekurudhorë);
6. Mos zbatimi i bazës ligjore në sektorin e transportit dhe lejimi i konkurrencës jo lojale;
7. Licencimi dhe futja në treg e operatorit hekurudhor privat, pa ndonjë analizë të mirëfilltë të tregut nga ana e institucioneve relevante;
8. Gjendja jo e mirë e mjeteve lëvizëse për shkak të vjetërisë së tyre dhe kostoja e lartë investuese;
9. Mungesa e një "Master Plani afatmesëm" për TRAINKOS-in;

10. Neglizhenca e institucioneve relevante të cilat veprojnë në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës në inkorporimin e operatorit shtetërorë në planifikimet strategjike për zhvillim industrial të vendit;
11. Mosha mesatare e lartë e personelit ekzekutiv;

Duke pasur parasysh që sfidat e lartcekura janë të natyrave të ndryshme dhe kërkojnë përkrahje edhe nga shumë institucione relevante, kompania është munduar në vazhdimësi që këto sfida/probleme t'i paraqes dhe të kërkojë zgjidhje/mbështetje, mirëpo marr parasysh karakterin e tyre ka qenë e pamundur arritja e rezultateve pozitive duke rezultuar edhe me mos përmirësimin e përgjithshëm të kompanisë.

Edhe në vazhdim ne mbetemi të përkushtuar dhe do të insistojmë që të gjitha këto probleme të trajtohen nga institucionet dhe faktorët tjerë relevant në mënyrë që të marrim zgjidhjen e duhur, me qëllim të zhvillimit të ndërmarrjes si aset shtetëror.

Për këto sfida të precizuara më lart përgjegjësit në kompaninë Hekurudhat e Kosovës - TRAINKOS Sh. A. sipas planifikimeve mbesin të përkushtuar në angazhimin maksimal në arritjen e realizimit të objektivave.

Gelor Shala
Kryeshef Ekzekutiv

Fushë Kosovë,
Korrik 2019